

MUSLIMANËT E MAQEDONISË
ORGANIZIMI I JETËS FETARE DHE SHOQËRORE
(Paneli “Ditët e Mevlanës” Konja-Turqi, dhjetor 1994)

Vllezër të nderuar,

Më lejoni që këtë tubim fillimisht ta përshëndes në emër të muslimanëve te cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë,e cila deri në vitin 1991 ka qenë element konstituiv i Jugosllavisë socialiste.

Gjithashtu më lejoni që t'u përshëndesë ne emër të Kryetarit të Mashihatit të BI në R.M.,h.Sulejman ef. Rexhepit i cili aktualisht është i nxënë me punë tjetër zyrtare,andaj nuk do të merr pjesë në punën e këtij tubimi,i cili ju dërgon selame të përzemërta për ftesën që i drejtuat eminences së tij.Njëherit ju përshëndes edhe në emrin tim personal dhe në emër të Medresesë "Isa Beu" në Shkup.

Vëllezër të nderuar,

Nuk ka dyshim se tubimet e këtilla kanë rëndësinë parësore e që është njoftimi i vëllezërve tanë në botën Islame me problemet dhe përpjekjet e diasporës së muslimanëve në tërë botën,për këtë rast në veçanti për vendet të cilat pas 50 vjetë u liruan nga zgjedha e komunizmit ateistë.Për këto tubime,të jeni të bindur se kanë rëndësi të madhe sepse ne e kemi vështirë të organizohenmi si pakica,aq më tepër në sistemet e reja postkomuniste,kur secili mundohet që në mënyrë të vetë të grabitë fitren e All-llahut xh.sh. që ia fali njeriut prej se kur ekziston dhe deri sa të ekzistojë.Për të fituar muslimanët e këtyre vendeve,me siguri dini ma mirë se ne në Maqedoni,mundohen shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare.

Përkundër kësaj,muslimanët të cilët jetojnë në Maqedoni,jemi këmbëngulës në kultivimin e jetës fetare në të gjitha lëmitë e jetës sonë shoqërore.

Të flasish për muslimanët e Maqdonisë mendoj se është e domosdoshme që të përmendi diç për retsrospektivën e ardhjes së Islamit në vendet e Ballkanit,andaj më lejoni që fjalën time ta filloj me këtë:

Islami i vendeve të Ballkanit

Për ardhjen ose depërtimin e Islamit në Ballkanedhese te historianët e etapave të ndryshme historike ka kundërthënie,mirëpo është e vërtetë e pamohueshme se Islami në Ballkan filloi të depërtojë përmes tregtarëve dhe duatëve të ndryshëm arab.Rruga tregtare:Venedik-Dubrovnik-Prizren-Manastir-Stamboll-Sham e Bagdad tregtarët e ndryshëm i detyronte që dash e padash të kontaktojnë me banortët e këtyre trojeve.Ashtu edhe tregtarët arab ose më mirë të them duatët e botës Islame shfrytëzonin rastin dhe kryejshin edhe obligimin Islam: “*Kuntum hajre ume.....*,” si dhe obligimet e Sunnetit të Pejgamberit s.a.v.s.Ndërkaq nëse kemi parasyshë tolerancën fetare në Islam, se Islami është *dinul-fitre* (fe instinkti) nuk bisedohet se banorët paganë apo posa të krishterizuar të pranojnë fenë e pastër Islamin.

Duke u mbështetur në këtë lirisht themi se Islami një Ballkan ka filluar të depërtojë që nga shekulli i tetë sipas erës sonë ose në shekullin e trtë sipas hixhretit.

Gjithashtu nuk është aspak diskutabile fakti se muslimanët e Ballkanët fenë Islame masovikisht filluan ta pranojnë përmes çlirimeve të Perandorisë Osmane, andaj sot shtetet e posafomuara nga ishjugosllavia e dikurshme numrojnë një numër të konsiderueshëm të muslimanëve.

Me rënien e kalifatit, muslimanët e Ballkanit mbetën si jetim për tre cilin nuk ka kush të kujdeset. Mu për këtë ata ishin të detyruar që në forma dhe mënyra ashtu siç dinin ta organizojnë vetëm jetën fetare kurrëgjë tjetër.

Pas vitit 1912, muslimanët e Ballkanit u ndanë në shtete të ndryshme, kështu që e patën shumë vështirë të ekzistojnë qoftë shpirtërisht qoftë edhe fizikisht. Si të ekzistojnë kur armiqët e muslimanëve filluan në çdo mënyrë të shtypin posaçërisht besimtarin. Mu për këtë brenda një etape të shkurtë historike numri i muslimanëve zvogëlohet në masë, disa bashkësi muslimane u zhdukën si ajo e Rumunise, Bullgarisë, Hungarisë etj.

Ndërkaq Bashkësia Islame e Jugosllavisë dhe e Shqipërisë duke u mbështetur në numrin më të madh të muslimanëve, në fuqinë kadrovike, në thesarin kulturor fetar që e trashëguan nga osmanlinjtë; edhe pse me vështirësi të mëdha u konsoliduan dhe mbijetuan si muslimanë. Kështu që muslimanët e këtyre vendeve përkundër presionit politik e ekonomik për asimilimin e tyre, në periudhën e viteve 1912-1939 ruajtën xhamitë, medresetë, bibliotekat, vakufet, thesarin e tyre kulturor ose me një fjalë ngelën muslimanë. Sa për informimin tuaj mjafton të përmendi se vetëm në Shqipëri deri kah vitet e pesdhjeta u ruajtën mbi 1048 xhami me 1315 nëpunës, medreseja e lartë e Tiranës bashkë me disa medrese tjera të ulëta regjionale, revistat fetare Islame si "Zani i Naltë", "Kultura Islame" etj. Ndërkaq në ishjugosllavi u ruajtën mbi 2300 xhami, medresetë e mesme si "Isa Beu" me bibliotekën në Shkup, medreseja e Gazu Husref Beut me bibliotekën në Sarajeve si dhe medresetë e ulëta dhe të ixhazetit nëpër vende më të vogla si në: Prizren, Prishtinë, Tetovë, Manastir, Travnik etj. Gjatë kësaj periudhe Bashkësia Islame botonte edhe disa gazeta e revista si: Glasniku, Novi Behar etj.

Organizimi i Bashkësisë Islame

Pas ndarjes së Bashkësisë Islame nga Stambolli, muslimanët për herë të parë në vitin 1882 formojnë qeverisjen fetare me emrin "*Ulema Mexhlis*" në krye të cilit ishte Reis-ul-ulemaja. Në fakt jetën fetare tani më muslimanët e organizojnë vetë dhe kështu në kuadër të këtij organi formohen edhe organe tjera më të ulëta të cilat fillimisht kishin për detyrë të regjistrojnë pasurinë e Ulema Mexhllisit si dhe vakufet të cilat i kishin lënë në interes të përgjithshëm, e në veçanti në interes të muslimanëve dhe institucioneve të saja.

Në vitin 1909 për herë të parë sillej Statuti i Ulema Maxhllisit i cili gjatë kohës si akt më i lartë i Bashkësisë Islame ngrihet edhe në nivel të Kushtetutës.

Në kuptimin administrativ Ulema Mexhlisi u nda në dy teritore edhe atë njëri teritor selinë kishte në Sarajeve e tjetri në Shkup. Ndërkaq si aktivitete më të përmendura të Ulema Mexhliseve të cilat vepronin në kuadër të sistemit mbretëror janë medresetë e niveleve të ndryshme. Është me rëndësi të përmendim se rreth vitit 1933 në Sarajevë për herë të parë shtypet Mus'hafi dhe disa libra tjera për nevojat e medreseve dhe të Bashkësisë Islame. Gjatë kësaj periudhe për herë të parë delegacione të ndryshme nga bota Islame vizitojnë muslimanët dhe organet e Bashkësisë Islame, njëherit edhe nga Ulema Mexhlisi vizitohen disa vende jashtë Mbretërisë. Përndryshe këto janë vizitat e para të niveleve zyrtare.

Pas Luftës së Dytë botërore paraqitet nevoja që Bashkësia Islame të organizohet në suaza të reja të rtendit të ri shoqëror. Andaj duke dashur që të jemi në hap me nevojat e kohës edhe në Organet e Bashkësisë Islame u bë transformimi i disa organeve duke filluar në piramidën prej lartë poshtë.

Sipas Kushtetutës së vitit 1969 Bashkësisë Islame e përbëjnë pesë Kryesi regjionale edhe atë sipas Republikave në përjashtim të Sllovenisë dhe Kroacisë të cilat ishin të futura në një Kryesi.

Në krye të Bashkësisë Islame është Reis-ul-ulemaja i cili njëherit është edhe Kryetar Suprem i muslimanëve dhe i Kryesisë Supreme të Bashkësisë Islame. Kuvendi Suprem është organi më i lartë legjislativ. Krahas kësaj në çdo Republikë qëndronte kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame i cili është organ ekzekutiv. Kuvendi i Bashkësisë Islame është organ legjislativ i muslimanëve të Republikës. Në vazhden e kësaj piramide nëpër vendet regjionale ishin këshillat e Bashkësive Islame dhe pastaj mutevel-litë e xhamive.

Bashkësia Islame jetën fetare nëpërgjithësi e organizon nëpërmes xhamive dhe mektebeve. Mirëpo duke filluar që nga vitet e pesëdhjeta deri kah fundi i viteve gjashtëdhjeta sistemi komunist në ishjugosllavi uzurpoi, nacionalizoi shumë objekte të Bashkësisë Islame, duke filluar nga xhamitë të cilat në numër të madh i rrafshoi me tokë, një numër tjetër kinëse i futi nën mbrojtjen e monumentve historike, një numër tjetër i rrëzoi koha dhe sotë e kësaj dite nuk mund të renovohen për shkaqe financiare etj.

Duke filluar prej viteve të shtatëdhjeta deri kah fundi i viteve të tetëdhjeta në Bashkësinë Islame paraqiten forca kadrovike të reja. Në ndërkohë gjendja ekonomike e muslimanëve heshtazi përmirësohet dhe këto dy faktor luajtën rolin e vetë të rëndësishëm në zhvillimin e jetës fetare në kushte krejtësisht tjera. Gjatë kësaj periudhe filluan të ndërtohen xhami në shumicë nga nisijativa e besimtarëve me ndihmën e Bashkësive Islame si organe ekzekutive dhe ligjdhënëse nënë sy të pushtetit aktual. Krahas peripetive të shumta besimtarët bashkë me organet e Bashkësisë Islame u gjetën në kohë dhe me të vërtetë brenda një dekade aritën për së afërmi në numër të këthejnë xhamitë e rënuara nga shkaqe të ndryshme.

Tani lindin ide të reja për hapjen e Fakultetit të shkencave Islame si dhe të medresesë në Shkup. E tërë kjo vjen nga fakti se kuadrot të cilat pas viteve shtatëdhjeta arinin të diplomuara nga bota Islame duhej të inkuadroheshin në punë

të mirfillta e një herit forca e tyre intelektuale gjunëzoi edhe kundërshtarët dhe ata ishin të detyruar të lëshojnë pe në disa kërkesa të Bashkësisë Islame sepse ajo veç ishte nevojë jo vetëm e muslimanëve por edhe e kohës.

Bashkësia Islame pas rënies së sistemit komunist

Duke filluar që nga viti 1991 e deri më sot Bashkësia Islame vepron në kuadër të Republikës së Maqedonisë si organizatë e pavarur. Andaj, me shpërbërjen e ishjugosllavisë është e nevojshme që edhe Bashkësia Islame të veprojë në formë krejtë tjetër dhe atë duke u nisur nga fakti i vuarjes së kufijve në mes republikave si dhe duke u nisur nga antagonizmat e krijuara në mes të popujve sllav dhe joslav.

Në krye të Bashkësisë Islame është kryetari i Meshihatit organ ky i cili është ekzekutiv në nivel të Republikës, ndërkaq Kuvendi i Bashkësisë Islame edhe më tutje mbetet organi më i lartë legjislativ.

Në Maqedoni funksionojnë 13 këshilla të Bashkësisë Islame në krye të të cilëve është kryetari i Këshillit.

Jeta fetare

Jetën fetare muslimanët kryesisht e zhvillojnë nëpër objektet fetare si në xhami, mesxhide, mektebe, teqe etj. Maksimalisht në Maqedoni funksionojnë mbi 560 xhami, mesxhide dhe teqe. Në pjesën dërmuese të xhamive falen pesë kohët e namazeve. Ndërkaq nëpër mektebet kryhet mësim-besimi i gjeneratave të reja.

Jetën fetare e organizojnë mbi 600 teolog prej të cilëve mbi 200 teolog posedojnë fakultetet përkatëse të cilët kanë diplomuar nëpër Universitetet e Botës Islame si: në Egjipt, në Arabinë Saudit, në Kuvajt, në Irak, në Libi, në Tyurqi, në Sarajevë etj.

Krahas faljes së pesë kohëve nëpër xhamitë kryesore të qyteteve regjistrohen edhe manifestimet tjera fetare si: nata e mevludit, hixhrteti i Pejgamberit s.a.v.s., netët e medhaja, bajramet etj.

Gjatë muajit të Ramazani Sherifit nëpër shumicën e xhamive mbahen tribuna të ndryshme me karakter fetarë, që njëherit edhe ndryshon formën e manifestimit të muajit të Ramazanit edhe atë me qëllim të ngritjes së ndërgjegjies Islame të xhemati.

Në disa xhami organizohet edhe hifzi i Kur'ani Kerimit krahas drejtëleximit. Në këtë drejtim tri xhamitë mbajnë kontinuitetin tradicional edhe atë xhamija e Isa Beut në Shkup, xhamia në fshatin Studeniçan të Shkupit dhe xhamia e Pashës në Tetovë. Kështu që për çdo vit në këto xhami bëhet promovimi i hafizëve të rinjë. Bashkësia Islame në bashkëpunim me hafizët e këtyre xhamive tërë këtë e bën që edhe në trevat e Maqedonisë t'i kushtohet kujdes ruajtjes tradicionale të Kur'ani Kerimit.

Aktivitet tjetër me rëndësi fetare është organizimi i haxhxit si kusht i pestë i themeleve të Islamit. Bashkësia Islame në këtë drejtim mundohet që haxhxit t'ia

ruajë rëndësinë fetare njëherit të ketë peshën e ibadetit e jo të ndonjë aranzhmani turistik. Nëse kemi parasysh këtë qëndrim të Bashkësisë Islame, atëherë nuk është e rastit që numri i të interesuarëve që kryejnë haxhxin përmes Bashkësisë Islame për çdo vit të rritet shumë e më shumë.

Kuadri fetar

Për të realizuar jetën fetare në Maqedoni është më se e nevojshme që Bashkësia Islame të ketë kuadër gjegjëse për të gjitha aktivitetet. Përndryshe nuk mund të mendohet ardhmëria e asnjë organizate e aq më pakë e Bashkësisë Islame. Bashkësia Islame tani për tani kuadrin kryesor e pret prej medresesë së mesme "Isa Beu" në Shkup. Njëherit ka qenë rrethanë lehtësuese që para vitit 1984 muslimanët e Maqedonisë kuadrot e veta i shkollonin në medresenë e "Alauddinit" në Prishtinë ose në medresenë e "Gazi Husrefbeut" në Sarajevë. Ndërkaq për të siguruar kuadër superior kryesisht kuadrot toba shkolloheshin në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë si dhe në botën Islame. Nisur nga këto kushte si edhe rrethanat vetanake të besimtarëve, Bashkësia Islame e Maqedonisë sot ka mbi 200 teolog të diplomuar nëpër qendra të ndryshme Universitare të botës Islame.

Duke u mbështetur në fuqinë intelektuale të kuadrove të Bashkësisë Islame si dhe me projektet për ndryshimet kadrovike në Bashkësinë Islame konsiderojmë se ky potencial kadrovik i Bashkësisë Islame ka mundësi të luaj rol in e vetë jo vetëm në Maqedoni por edhe më gjërë.

Krahas shkollimit dhe përgaditjes së kuadrit fetarë Bashkësinë Islame të Maqedonisë sot e mundon edhe shkollim i i kuadrit fetar nga gjinia femrore. Andaj në këtë drejtim mendojmë se së shpejti medreseja e Isa Beut veç jep rezultatet e para. Sa për shembull mund të përmendim se tani për tani në Bashkësinë Islame mual-limeja si faktor dhe gjenerator për ngritjen e ndërgegjegjies fetare, nëna muslimane jep rezultatet e veta. Në këtë drejtim së shpejti mendojmë që të hapet edhe paraleleja e rregullt e femrave në kuadër të Bashkësisë Islame.

Gjendja materiale e Bashkësisë Islame

Bashkësia Islame është organizatë joqeveritare, andaj pushteti aktual si edhe të parët nuk dodatojnë kurrë nga buxheti shtetëror për këtë organizatë. Kjo detyron muslimanët e Maqedonisë që të vetëorganizohen dhe të gjejnë forma të finansimit dhe të sigurojnë buxhetin e vet vjetor dhe afatgjatë.

Bashkësia Islame buxhetin e vetë kryesisht e siguron nga institucionet fetare si: sadakatul-fitri, zeqati i pasurisë, lëkurëve të kurbanëve, mishit të kurbanëve, organizimit të haxhshit, ndihmave bullnetare dhe në numër shumë të vogël nga vakufet.

Sistemi monist nga Bashkësia Islame uzurpoi shumicën e vakufëve që njëherit edhe ishin burimet kryesore, mirëpo insha-All-llah me sjelljen e ligjit të ri për

denacionalizimin e pronës private si edhe vakufeve kujtojmë se edhe gjendja ekonomike në Bashkësinë Islame dukshëm do të përmirësohet.

Bashkësia Islame përmes tubimit të fondeve në fjalë siguron rogen mujore të nëpunësve nëpër organet e Bashkësisë Islame, siguron punën e medresesë, finansimin e Bibliotekës së Isa Beut në Shkup, shtypin e edicionit fetarë, meremetimin e disa xhamiave sidomos në Maqedonisë Lindore ku muslimanët janë pakicë etj.

Institucionet e Bashkësisë Islame

Bashkësia Islame në kuadër të vetë ka edhe disa institucione si:

1. Shkolla e Mesme Islame "Medreseja Isa Beu" në Shkup,
2. Bibliotekën "Isa Beu" në Shkup,
3. Këshillin për botime,
4. Fakultetin e studimeve Islame dhe
5. Organizata humanitare "El-Hilal".

1. Shkolla e Mesme islame “Medreseja Isa Beu”

Medreseja Isa Beu ndjek traditën e vjetër të Medresesë së Isa Beut e cila është themeluar në fillim të shekullit XV. Medreseja e atëhershme merr emrin sipas themeluesit Isa Beu, djal i Is'hak Beut – pashë i Mbretërisë Osmani për këto vende. Medreseja për kohën kur vepro paraqitte shkallën më ta lartë arsimore. Në kompleksin e Medresesë, krahas shkollës ekzistonin xhamija dhe biblioteka të cilat mbanin të njejtin emër të themeluesit. Në krahasim me shkollat tjera, Medreseja ishte më e madheja në Maqedoni dhe është më e vjetër se Medreseja e Gazi Husrefbeut në sarajevë.

Prej kohës kur u themelua kjo Medrese e gjer më tani përjetoi ca ndërprerje të punës edukativo – arsimore, nga kjo nënkuptojmë se godina e Medresesë është meremetuar ose është rindërtuar disa herë. Ndërprerja e parë e punës ndodhi në vitin 1689 kur Pikolomini – komandant i ushtrisë Austro – hungareze - e dogji Shkupin. Mbeturinat e Medresesë u ruajtën deri para Luftës së Dytë Botërore. Pas Luftës së parë Botërore Medreseja e Isa Beut për herë të parë rikonstruohet në vitin 1932 ndërkaq inaugurimi i objektit bëhet në vitin 1936. Kështuqë me fillimin e Luftës së Dytë Botërore në vitin 1941 Medreseja ndërprete punën dhe nuk punoi deri në vitin 1984.

Në Medresenë e paraluftës shkolloheshin nxënës nga Maqedonia, Koaosva, Sanxhaku dhe Serbia Jugore. Medreseja punonte me plan-programet e shkollave të mesme duka ia shtuar edhe lëndët fetare.

Nisur nga nevoja kadrovike e Bashkësisë Islame si dhe nga të dhënat historike për ripërtirjen ose rindërtimin e Medresesë në fjalë, Bashkësia Islame e Maqedonisë në vitin 19978 për herë të parë ngriti idenë për hapjen e medresesë në Shkup. Në vitin 1979 ideja për hapjen e medresesë u shqyrtua edhe në organet republikane dhe ato federative të ish Jugosllavisë, andaj organet kompetente

brenda një viti përgaditën dokumentacionin e nevojshëm administrativ , juridik e politik të kohës. Kështuqë në 17 Ramazan të viti 1980, në fitoren e Betejës së Bedrit, muslimanët e Maqedonisë fituan medresenë me vendimin e gurthemelit të këtij institucioni edukativo arsimor.

Puna rreth ndërtimit të godinës së Medresesë përkohsisht ndërpritet për shkak të mungesës së mjeteve materijale dhe ca mosmarrëveshjeve politike, por më në fund në pranverën e vitit 1982 në mënyrë intenzive vazhduan punimet dhe me 15 tetor të vitit 1984 në mënyrë madhështore Medreseja fillon punën e vetë të shenjtë.

Për tërë punën që u krye rreth godinës së Medresesë merita i takon popullatës muslimane të Maqedonisë të cilët nga goja e vetë ndanë kafshatën e gojës për ndërtimin e kompleksit të Medresesë dhe Bashkësisë Islame e cila me punën e vetë arsyetoi dhe arsyeton qenien e këtij institucioni edukativo arsimor.

Kompleksi i Medresesë së isa Beut është i vendosur në fshatin Kondovë afër Shkupit, i venduar në siparfaqe prej 7000 metër katror kurse nën kulm ka 3000 metër katrorë. Kompleksi kryesisht përbëhet prej tri ndërtesave:

- ndërtesa e shkollës ku gjenden tetë klasë mësimi, dy kabinete të gjuhëve, kabineti i informatikës, mesxhidi, biblioteka me sallën e leximit, kafeterija dhe zyrat e administratës së Medresesë.
- Ndërtesa e konviktit ku janë të vendosura 53 dhoma të fjetjes me nga katër dhe pesë krevatë, dhomat e aktiviteteve të lira, banjot, stacionari i nxënësve, koftorët për nxemjen qendrore, lavatriçet dhe strehimorja.
- Ndërtesa e kuzhinës ku janë të vendosura restorani, kuzhina dhe depot e ushqimit. Ndërkaq në hapsirë të hapur Medresja ka edhe fushën e sportit.

Sipas Kushtetutës së BI-së dhe akteve normative të Medresesë, Medreseja është shkollë e mesme islame dhe ka statusin e shkollave të mesme profesionale. Qëllimi parësor i Medresesë është; të përgatit kuadër të nevojshëm për Bashkësinë Islame në Maqedoni e më gjerë.

Regjistrimi i nxënësve bëhet përmes konkursit i cili zakonisht shpallet në mes të qershorit. Për tu regjistruar në Medrese nxënësi duhet të paraqet dëftesat e shkollës fillore të klasës së gjastë, klasës shtatë dhe klasës së tetë. Krahas kësaj, nxënësi i nënshtrohet provimit pranues dhe sipas suksesit që ka arritur dhe sipas Rregullores për pranimin e nxënësve bëhet pranimi i nxënësve. Në dy vitet e fundit pranimi i nxënësve bëhet sipas Rregullores së re dhe cilësia e nxënësve është në nivelin e knaqshëm.

Për çdo vit shkollor në Medrese kryesisht regjistrojmë nga dy paralele. Në Medrese regjistrohen nxënësit nga Maqedonia po sipas mundësive edhe jashtë Republikës.

Duke u mbështetur në Statutin e Medreseë, nxënësit brenda katër viteve sa edhe zgjat shkollimi mësojnë gjithësejtë 29 lëndë mësimore ose të ndara në vite:

- në vitin e parë mësohen gjithësejtë 15 lëndë,
- në vitin e dytë mësohen gjithësejtë 16 lëndë,

- në vitin e tretë mësohen gjithsejtë 17 lëndë dhe
- në vitin e katër mësohen gjithsejtë 16 lëndë.

Lëndët mësimore mund t'i ndajmë në tri grupe:

- grupi i lëndëve filologjike: gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha maqedone, gjuha arabe dhe gjuha angleze.
- Grupi i lëndëve fetare – profesionale: kiraet, akaid, fikh, historia dhe civilizimi Islam, ahlak, da've, tefsir, hadith, usuli fikh, retorikë, filozofi Islame.
- Grupi i lëndëve të përgjithshme: histori, gjeografi, biologji, informatikë, matematikë, mbrojta e përgjithshme popullore, psikologji, logjikë, pedagogji, sociologji dhe filozofi e përgjithshme.

Nxënësi pasi të kryejë katër vitet i nënshtrohet provimit të pjekurisë në lëndët profesionale. Për këtë i jepet diploma e cila shërben për dokument përfundimtar për shkollimin në Medrese.

Plan-programet e lëndëve, kushtimisht të them, shkencore dhe të gjuhëve i marrim nga Komiteti për kulturë arsim dhe kulturë fizike si dhe për të njejtat shërbehemi me tekstet mësimore nga Enti Pedagogjik Republikan.

Për sa u përket plan-programeve të lëndëve fetare, ata janë të përpiluara nga komisionet e formuara në nivel të tri medreseve ekzistuese në ish Jugosllavi. Për çdo lëndë profesori gjegjës ka përgaditur dispencën mësimore sipas plan-programeve të hartuara. Për këtë mund lirisht të përmendi se dispencat janë të përgaditura në nivel shkencor që njëherit vërtetojnë përgaditshmërinë e arsimtarit të lëndës.

Deri në fillim të vitit shkollor 1994/95 në Medrese u regjistruan gjithësejtë 1407 nxënës prej të cilëve 751 të rregullt dhe 656 nxënës me korespondencë prej të cilëve 376 janë të gjinisë femrore dhe 280 të gjinisë mashkullore. Ndërkaq nga nuymri i përmendur më lartë, deri në fund të vitit shkollor 1993/94 në Medrese diplomuan gjithsejtë 293 nxënës të rregullt, 8 nxënës me korespondencë dhe 25 nxënëse me korespondencë.

Nxënësit që kanë kryer Medresenë kryesisht vazhdojnë studimet. Një numër i vogël punësohet në Bashkësinë Islame si imamë, mual-limë ose në shërbime tjera. Nxënësit e Medresesë studimet kryesisht i vazhdojnë nëpër qendrat universitare të botës Islame si Kajro – Universiteti i Al-Az'harit, Tunis – Universiteti Ez-Zjetun, Jordani, Turqi, Arabi Saudite, Libi dhe në universitetet e vendit si në Shkup e Manastir.

Në Medrese, krahas shkollimit të rregullt Këshilli i Arsimtarëve organizon edhe provimet me korespondencë pasi që interesimi i nxënësve për këtë profesion është shumë i madh. Provimet kryesisht mbahen brenda tri sesioneve: janar, qershor dhe shtator.

Dukuri pozitive e nxënësve me korespondencë është interesimi shumë i madh i femrës muslimane për t'u shkolluar në Medrese, andaj duke filluar prej vitit shkollor 1993/94 ishim të detyruar që edhe regjistrimin e nxënësve me korespondencë ta kufizojmë përmes provimeve pranuese.

Finansimi i Medresesë

Medreseja kryesisht finansohet nga institucionet fetare duke filluar nga zeqati, zeqatul-fitri, lëkurët e kurbanëve, mishi i kurbanëve ndihmat vullnetare etj. Njëherit burim tjetër është edhe ndihmat vullnetare në artikuj ushqimor dhe mjete tjera.

Gjatë viteve tetëdhjeta, gjendja ekonomike e muslimanëve ishte e mirë aq më tepër që bindja për mirëmbajtjen e Medresesë ishte shumë e fortë. Andaj me vështirësi shumë të vogëla mund të tejkalonim pengesat eventuala që paraqiteshin. Mirëpo, me shpërbërjen e ish Jugosllavisë një numër i madh i muslimanëve të punësuar nëpër republikat tjera u kthyen duar thatë në vendlindje dhe u bënë objekt i ndihmave e jo sikur më parë ishin subjekte që investonin jetën fetare nëpër gjithëse e edhe Medresenë në veçanti.

Shkollimi i nxënësve nga Shqipëria dhe Bullgaria

Medreseja në kohën e fundit merr karakterin e shkollimit në nivel Ballkanik sepse këtu shkollohen nxënës nga Kosova, Sanxhaku, Shqipëria dhe Bullgaria.

Mirëpo, dukë marrë parasysh se në Kosovë, Sanxhak dhe Bullgari kanë filluar të funksionojnë medrese të llojit të Medresesë së Isa Beut në Shkup ne do të pranojmë nxënës vetëm në kuptimin simbolik. Ndërkaq, nga Shqipëria ku nevoja kadrovike është shumë e madhe si dhe medrese të këtij lloji mungojnë do të pranojmë një numër më të madh. Sa për ilustrim më lejoni të përmendi se që nga viti 1993/94 e deri në vitin shkollor 1994/95 në Medrese shkolloheshin gjithsejtë 11 nxënës nga Shqipëria duke mos llogaritur nxënësit që lëshuan shkollimin nga vetë dëshira e tyre.

Nxënësve nga Shqipëria si dhe nxënësve tjerë u garantohet shkollimi gratis. Krahas kësaj për nxënësit e Shqipërisë dhe të Bullgarisë Medreseja në bashkëpunim me Meshihatit e Bashkësisë Islame iu siguron tekstet mësimore gratis.

2. Biblioteka e Isa Beut

Biblioteka e Isa Beut në Shkup është hapur në vitin 1990 dhe si e tillë është e vetmja e këtij lloji në Republikë. Biblioteka tani për tani kryesisht meret me tubimin e librave të vjetra si dhe për të ruajtur thesarin e vjetër të dorshkrimeve dhe origjinal. Si institucion i ri biblioteka ka tubuar një numër të madh të dorshkrimeve me përmbajtje fetare, historike dhe shkencore. Pas sistematizimit të punës së bibliotekës do të përpiqemi që biblioteka të jetë e hapur për lexuesin dhe do të jetë publike me qëllim që të shërbejë për nevojat e besimtarëve të këtyre trojeve.

Në nëdër kohë do të përpiqemi ë bibliotekës t'i kthehet fondi i librave të vjetra të cilin fond pas Luftës së Dytë Botërore pushteti komunist e uzurpoi me qëllim që

të shkatërroje çdo institucion fetar. Mirëpo, si duket fatmirësisht këtë fond të librave e kanë ruajtur në Arkivin shtetëtor dhe institucione tjera shtetërore.

3. Këshilli për botime

Këshilli për botime i Bashkësisë Islame vepron në dy drejtime:

a) Botimi i gazetës “Hëna e Re” e cila botohet në tri gjuhë: shqip, turqisht dhe maqedonisht. Gazeta është dy javore. Koncepti parësor i gazetës është që të drejtëinformojë besimtarët me rrjedhat e punës së Bashkësisë Islame si dhe aktivitetet që i ndërmerrë. Në rubrikat e parapara nga shkencat Islame përfshihen tema aktuale për kushtet dhe rrethanat tona ku jetojmë. Përmes gazetës njëherit bëhet edhe arsimimi Islam i besimtarëve.

b) Botimin e edicionit fetar të shkencave të ndryshme për të plotësuar shpraztirën e krijuar nga e kaluara. Brenda dy viteve të fundit Bashkësia Islame ka botuar mbi 35 tituj të përkthyer nga gjuha arabe, turke, boshnjake dhe botime origjinale. Me këtë dukshëm është përmirësuar fondi i botimeve me përmbajtje Islame.

4. Fakulteti i studimeve të shkencave Islame

Fakulteti i Shkencave Islame momentalisht nuk vepron, por Meshihati i Bashkësisë Islame pandërpre përpiqet që të gjejë formën se si të jetësohet ky Fakultet. Përpjekjet për jetësimin e Fakultetit bëhen në dy drejtime:

- a) për sigurimin e dokumentacionit nga pala e shtetit dhe
- b) sigurimi i mjeteve për ndërtimin dhe punën e Fakultetit.

Mendoj se të flasim për nevojën e ndërtimit të Fakultetit do të ishte e tepërt sepse të flasësh për nevojën e mësimin do të thotë shumë. Njëherit duke u nisur nga fakti se nevoja e muslimanëve në Maqedoni për Fakultetin është shumë e madhe them se hapja e Fakultetit të Shkencave Islame është imperativ i kohës.

5. Organizata bëmirese “El-Hilal”

Pasiqë Kryetari dhe sekretari i Organizatës në fjalë janë prezent, unë në këtë nuk do të ndalem aspak.

* * *

PROF. BAHRI ALIU
DREJTOR
“SHMI MEDRESEJA ISA BEU”
SHKUP - MAQEDONI